



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 3.1, pikat b dhe h të Rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr. 2000/45, të dt. 11 gusht 2000 dhe të nenit 19, par.1, pikat b dhe ë të Statutit dhe Rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës, të dt. 16.3.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 27.12.2006, merr

V E N D I M
PËR REALIZIMIN E PËRMBAJTJEVE TË PLANIT DETAL “KODRA E DIELLIT 1” NË PRISHTINË NË BAZË TË KONTRATËS MBI KONCESIONIN

Neni 1

Miratohet Vendimi për realizimin e përmbajtjeve të planit detal “Kodra e Diellit 1” në Prishtinë në bazë të kontratës mbi koncesionin.

Neni 2

Realizimi i përmbajtjes nga neni 1 i këtij Vendimi sipas kontratës mbi koncesionin, paraqet fazë të realizimit të planit detal “Kodra e Dielli 1” në Prishtinë, me destinim për ndërtimin e kinemasë, qendrës kulturore me bibliotekë dhe qendrës së Bashkësisë lokale dhe përmbajtje tjera përcjellëse, në pjesën e ngastrave kadastrale 2741/1 dhe 2742, Zona kadastrale – Prishtinë.

Projekti ideor do të hartohet në bazë të kriterëve urbane, të përcaktuara nga Drejtorati i Planifikimit, Urbanizmit dhe i Ndërtimtarisë i Komunës së Prishtinës, në bazë të planit detal nga neni 1 i këtij Vendimi.

Neni 3

Realizimi i përmbajtjes së planifikuar sipas kontratës mbi koncesionin do të bëhet përmes ofertave publike dhe procedurave tjera ligjore të parapara për dhënien me koncesion.

Neni 4

Para nënshkrimit të kontratës me koncesionarin e zgjedhur sipas procedurës nga neni 3 i këtij Vendimi, kontratën do ta shqyrtojë dhe miratojë Komiteti për Politikë dhe Financa i Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Neni 5

Për realizimin e përmbajtjes së planifikuar sipas këtij Vendimi dhe për përmbushjen e kushteve të përcaktuara me kontratën mbi koncesionin, do të kujdeset kryeshefi i Ekzekutivit të Komunës së Prishtinës përmes Bordit të drejtorëve.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit të tij.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01 Nr. 35-586, më 27.12.2006

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri